



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 155 Datë 28.12.2020

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare “

Në mbështetje të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “ për qeverisjen vedore”,Ligjit Nr.107 datë 22.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit Nr.45 datë 18.07.2019 “ për mbrojtjen Civile”,VKM Nr.329 datë 16.05.2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “ kreu III,pika 1,gërma ë,dhe Vendimit nr,76 prot.datë 02..8.2017,pika IV,Këshilli Bashkisë,në mbledhjen e tij, datë 28.12.2020 miratoi me 18 vota pro 0 kunder 0 apstenim.

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin shtëpi banimi 2 katëshe ( kati përdhe) ne pronësi të z.Osman Deshati njësia administrative Peshkopi (Lagj.Nazmi Rushiti),në shumën totale 27,025 lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim.
3. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej 13512.5 lekë ( 50% të vlerës totale të dëmit )për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
4. Për pjesën tjetër të vlerës së patrajtuar,për pamundësi financiare,do të dërgohet dokumentacioni në Institucionin e Prefektit Qarkut Dibër për AKMC pranë Ministrisë Mbrojtjes Tiranë për kompensimin e vlerës së mbetur për trajtim nga program i “Emergjencave Civile”.
5. Ky vendim hynë në fuqi pas konfirmimit nga Institucini i Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmëri ligjore.

KRYETAR KËSHILLI

SOKOL SAVA



Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUFI”, Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935